



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 163 prot.

Kamëz, më 19.12 2024

VENDIM

Nr. 119 Datë 19/12 /2024

**“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KAMËZ PËR VITIN 2025”**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. 19/12/2024, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.89 dt 27/11/2024, **Në mbështetje të:**

- Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6,
- Ligjit nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,
- Ligjit nr. 10 296 dt. 08.07.2010 , “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin ,, indryshuar
- Ligjit nr. 68/2017 dt. 27/04/2017“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”i ndryshuar ,nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3
- Shkresa e MF nr. 14488 dt 29.10.2024 “Dërgohet Njoftim transferta e Pakushtëzuar e pergjithshme dhe Sektoriale për vitin 2025”,
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit Bashkiak “Për Miratimi i Pakëtës Fiskale për vitin 2025”.
- V.K.M –së nr.328, datë 31.05.2023 “Për Klasifikim e Funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar ,
- V.K.M Nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin e Territorit,, .
- Ligjit nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar.
- Ligji nr.79/2017 “Per Sportin”
- Ligji nr.22/2018 “Per Strehimin Social”, i ndryshuar
- VKM Nr. 1720 datë 29.12.2008 “Për Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë Sportiv .” e dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
- Udhëzimi nr.395 dt 05.08.2019 “Per forcimin e administrates se Keshillit Bashkiak ,,

V E N D O S I

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Kamëz për vitet 2025-2027 si më poshtë vijon:

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë Kamëz për periudhen 2025-2027, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Nr	EMERTIMI	PLANI	PLANI	PLANI
		Vjetor 2025	Vjetor 2026	Vjetor 2027
1	Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme	915,129,450	957,651,948	1,001,928,502
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	445,858,708	445,858,708	445,858,708
3	Të Ardhurat nga Taksat e Tarifat Vendore	3,889,180,480	3,939,176,115	3,895,256,854
	Totali	5,250,168,638	5,342,686,771	5,343,044,064

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë Kamëz për periudhen 2025-2027, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Nr	Shpenzime sipas klasifikimit	PLANI	PLANI	PLANI
		Vjetor 2025	Vjetor 2026	Vjetor 2027
1	Shpenzime, paga e sigurime shoqerore e shendetsore Bashkia, Arsimi parashkollor, parauniversitar ndihmes & tre ndermarjet e Varesise	1,845,011,287	1,993,120,270	2,047,667,871
2	Shpenzime, operative Bashkia, Arsimi parashkollor, parauniversitar ndihmes & tre ndermarjet e Varesise	1,222,154,034	1,199,617,078	1,254,807,557
3	Shpenzime Kapitale, Bashkia & tre ndermarjet e Varesise	2,183,003,317	2,149,949,423	2,040,568,635
	Totali	5,250,168,638	5,342,686,771	5,343,044,064

2. Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2025 si më poshtë vijon:

➤ Plani i të ardhurave të Bashkisë Kamëz për vitin 2025, është në shumën 5,250,168,638 lekë, detajuar si më poshtë:

Plani i të ardhurave	Në lekë
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	3,889,180,480
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	915,129,450
Të ardhura nga transferta sektoriale	445,858,708
Totali	5,250,168,638

➤ Plani i shpenzimeve të Bashkisë Kamëz për vitin 2025, është në shumën 5,250,168,638 lekë, detajuar si më poshtë:

Plani i shpenzimeve	Në lekë
Shpenzime korrente	2,551,306,613
Shpenzime kapitale	2,183,003,317
Fond rezerve, kontigjence	70,000,000
Shpenzime nga transferta sektoriale	445,858,708
Totali	5,250,168,638

3. Miratimin e Tabelave të P.B.A-së faza e tretë për periudhën 2025-2027 sipas S.M.B.V (Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor).
4. Miratimin e Tabelave të Buxhetit Vjetor për vitin 2025 sipas S.M.B.V (Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor).
5. Miratimin e strukturës buxhetore për vitet 2025-2027, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur.
6. Miratimin e strukturës buxhetore për vitin 2025, sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur.
7. Miratimin e numërit të punonjësve të Bashkisë Kamëz dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2025, sipas tabelës nr.3 bashkëlidhur këtij projekt vendimi si më poshtë: punonjës gjithsej do të jenë 1,561 (njëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një).
8. Miratimin për sportistet e klubeve sportive në varësi të Bashkisë Kamëz, që në bazë të legjislacionit në fuqi pëmbushin kriteret për përfitimin e statusit të nivelit të lartë, të përfitojnë trajtim ushqimor në vlerën 2,500 (dymijë e pesëqind) lekë në ditë për 25 (njëzetë e pesë) ditë në muaj.
9. Efektet financiare të fillojnë nga data 01.01.2025.
10. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut

KRYETARI I KESHILLIT
HYSEN KOLDASHI

